

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Mobility Green" SHPK**

Sot më datë 31.01.2022, ne baze te ligjit tregtar themelohet shoqeria si me poshte:

Ortakë:

Arzeda Daja, atësia Ardian, amësia Tushe, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në Peqin, me adresë L.Xhami; Nd. 008; Peqin; Peqin; 3501; Peqin, lindur më 09/08/1988, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte Nr. BA5705187 dhe nr. personal I85809017U

Ne baze te Ligjt Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqëritë tregtare" dhe ne ligjt Nr. 9723, date 03.05.2007 për Q.K.R, kërkoi redaktimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqërisë me përgjegjësi te kufizuara si me poshtë vijon:

**NENI I
EMERTIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërisë është "Mobility Green" Shpk (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2
SELIA LIGJORE**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresë: **1052 Yzberish Pallati Lorena shpk ap.3 shk.1, TIRANE, Tirane**
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund te vendose mbi transferimin e selisë se Shoqërisë ne një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë.

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe te pacaktuar

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQERISE**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e te gjitha aktivitetave qe një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, duke përfshire por pa u kufizuar ne:

- **Import Eksport, shitjeblerje mjete motorike të reja dhe të pëdorura.**
- a) importin, eksportin, tregtimin me shumicë dhe pakicë të mjeteve motorike të reja dhe të përdorura, motoçikletave, traktorëve bujqësore, bicikletave, karvanëve, kampeve, varkave dhe në përgjithësi çdo artikulli në sektorin e motorizimit, tregtimin e preparateve dhe pajisjeve industriale të reja dhe të përdorura, automjete, shitja e pjesëve të këmbimit, lubrifikantëve, karburanteve, aksesorëve, radiove të makinave; shitjen me koncesion me ose pa depozitë të të gjithë artikujve të specifikuar më sipër,

makinave; shitjen me koncesion me ose pa depozitë të të gjithë artikujve të specifikuar më sipër, marrjen e mandateve të agjencisë dhe përfaqësimin në përgjithësi, menaxhimin e punishteve mekanike, punishteve elektro-mekanike dhe karrocerisë

- b) ndërmarrjen e kontratave të ndërmjetësimit tregtar dhe financiar, në çdo formë, në lidhje me sektorët e qerasë, leasing-ut, sigurimit, kredisë dhe garancisë;
- c) kryerjen e operacioneve të dhënies me qira të aktiveve, të zgjedhura nga qiramarrësi, të mbajtura më parë në dispozicion të qiramarrësit me anë të qirasë;
- d) kryerjen e operacioneve të qirasë dhe të çdo operacioni tjeter që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me qiranë.

4.2 Për te realizuar objektin e aktivitetit te saj, Shoqëria mund te veproje ne Shqipëri dhe jashtë, dhe te kryeje çdo aktivitet tjeter te nevojshëm, te lidhur, instrumental, te përafërt, elementar, ose sidoqoftë te dobishëm, për shembull:

Te ofroje garanci reale dhe/ose personale si për detyrime te vetat, ashtu edhe për te tretët. Te marre përsipër, te lejoje dhe ose te heqë dore nga pjesëmarrje direket ose indirekte ne shoqëri te tjera dhe ndërmarrje, si Shqiptare ashtu edhe te huaja, qe kryejnë veprimtarinë e tyre ana tyre, me qellim qe te lehtësojnë realizimin e objektit social; Veprimtari tregtare dhe industriale, import dhe eksport te mirash, shërbimesh dhe produktesh;

Ne kuadër te ligjit, te krijoje veprimtari dhe filiale te përfaqësimit.

NENI5 KAPITALI I SHOQERISE

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabarte me 100.000 leke
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë perbehet nga 1 kuota, si me poshte vijon:
 - *I kuote qe perben 100 % te kapitalit, me vlerë te pergjithshme 100.000 Leke, e shlyer nga ortaku Arzeda Daja.*
- 5.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaku themelues.
- 5.2 Asnjë nga ortaket nuk mund te transferoje kuoten përkatëse te pjesëmarrjes ne Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim te ortakeve te tjerë. Ne rast se një nga ortaket dëshiron te kaloje/transferoje plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij ne Shoqëri, duhet t'ia ofroje ketë kuote për blerje ortakeve te Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjete) diteve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortaket do te kenë te drejtë të blejnë kuotën e ofruar ne shitje sipas çmimit dhe mënyrave te pagesës për te cilat kane rene dakord me ortakun shitës.
- 5.3 Ne rast zmadhimi apo zvogëlimi te kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortaket do te kenë te drejtë të nënshkrimit te zmadhimit apo zvogëlimit te kapitalit ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen qe zoteron secili ne kapitalin e Shoqërisë.

NENI6 KALIMI I KUOTES ME TRASHEGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT



- 6.1 Ne rast vdekje apo falimentimi te njërit prej ortakeve, kalimi i kuotës dhe i te drejtave përkatëse ne favor te trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet te shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit te ortakut. Ne rast refuzimi te pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit te sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguaje trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta vlerën e kuotës qe do te përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore te Shoqërisë dhe vlerën e tregut te kuotës.
- 6.2 Personi qe fiton te drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku mund te zgjedhe te behet zotërues i kuotës ose te kërkoje regjistrimin e kuotës ne emër te një personi tjeter te zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh te behet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë ne lidhje me këtë vendim.
- 6.3 Personi qe fiton te drejtat mbi një kuote për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku do te këtë te drejtat qe gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përashtuar te drejtën e pjesëmarrjes ose te votës ne çdo mbledhje te Asamblesë se Përgjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit si zotërues i kuotes.

NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve qe janë thirrur por nuk ishin te pranishëm ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme qe vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kenë te drejtën te nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne përpjesëtim te drejte me kuotat qe zotërojnë ne Shoqëri.
- 7.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nënshkrimit te pjesës se tyre, kapitali i panënhkruar prej tyre mund te nenshkruhet nga ortaket e tjerë. Ne këtë rast, këta ortake mund te ushtrojnë serish te drejtën për nënshkrimin e kapitalit, ne përpjesëtim te drejte me kuotat e pjesëmarrjes ne Shoqëri.

NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zvogëloje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund te zvogëlohet nen kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortaket e përballojnë zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

NENI 9 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi te gjitha çështjet për te cilat është kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakeve te Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme, te shprehe vullnetin e tij si dhe te votoje ne përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zotëron ne Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokure me shkrim .
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshire telekonferencën (conference call) audio ose video, ne përputhje me ligjin për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme do te quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratoret ose nga ortaket ne baze te nenit 84 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirrja e mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme duhet te behet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqërisë te paktën 7 (shtate) dite përpëra datës se caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do te mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortaket apo përfaqësuesit e tyre janë te pranishëm dhe bien dakord te vendosin ne lidhje me rendin e dites.
- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme kryesohen nga Administratoret. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje nder personat e pranishëm.
- 9.7 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkese te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet te pakten një here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e viti financiar.
- 9.9 Asambleja e Pergjithshme, perveçse per sa parashikon nenit 9.10 i ketij Akti Themelimi dhe Statuti, per vendime qe kerkojne shumicen e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote ose perfaqësuesit e tyre, qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete per qind) te kapitalit te Shoqerise, sipas nenit 86 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqerite tregetare".
- 9.10 Asambleja e Pergjithshme vendos me votat pro te te pakten 51 % te ortakeve pjesemarres (shumica e kualifikuar) ne baze te nenit 87 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqerite tregetare", per ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

NENI10
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/et i cili/te cilët për një periudhe prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori/et mund te rizgjidhen dhe shkarkohen ne çdo kohe nga Asambleja e Përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 1 administrator:

Arzeda Daja

- 10.2 Administratori/t zotëron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme për realizimin e objektit te Shoqërisë, përvcevë veprimeve, përbushja e te cilëve i rezervohet Asamblesë se Përgjithshme apo organeve te tjera te Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjate administrimit te Shoqërisë dhe mund te autorizoje persona te trete, për te përbushur veprime te caktuara, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë. Ne çdo rast, administratori do te jete përgjegjës për veprimet e te tretëve te autorizuar.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratoreve te shoqërisë.
- 10.4 Administratoret nuk do te mund te marrin hua nga Shoqëria ose te lëshojnë garanci, dorëzani, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë, për hua dhe financime te dhëna nga te tretet.
- 10.5 Administratoret do te veprojnë ne çdo kohe yetëm ne interesin me te mire te Shoqërisë. Ne rast konflikti interesit, Administratori do te njoftoje menjëherë ortaket si dhe do te heqë dore nga çdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI11
VITI FINANCIAR

- 11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

NENI12
KONTROLI FINANCIAR

- 12.1 Kontrolli finansiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël te Autorizuar, sipas legjisacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne atë raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët ne baze te ligjt.

NENI 13
BILANCI VJETOR

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe te Ekspertit Kontabël te Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme .
- 13.2 Dokumentet qe kane te bëjnë me vitin finansiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit finansiar.

**NENI 14
DIVIDENDET**

- 14.1 Ne përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendsos mbi shpërndarjen e dividendëve ne baze te rezultatit financiar te shoqërisë.

**NENI15
ZGJIDHJA E MOSMARREVE SHJEVE**

- 15.1 Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakeve, administratoreve, likuiduesit, do t'i nënshtrohen juridiksonit te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane.

**NENI16
GJUHA**

- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet ne 4 (katër) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

**NENI17
DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

- 17.1 Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me ketë Akt Themelimi dhe Statut dhe ne përputhje me legjisacionin shqiptar ne fuqi. Për sa nuk parashikohet ne ketë Akt Themelimi dhe Statut, do te zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

ORTAKET E SHOQERISE

Arzeda Daja

